

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 7966  
E shtunë, 11 janar 2025  
Çmimi 0.50 €

## Qeveria miraton rritjen e pensioneve për kategoritë e luftës



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# SOT ZYRTARISHT FILLON FUSHATA PËR ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT

Sot (e shtunë), më 11 janar, subjektet politike do ta fillojnë zyrtarisht fushatën zgjedhore. Për një muaj partitë dhe kandidatët do të tentojnë t'i bindin votuesit që t'i zgjedhin ata. Këto do të jenë zgjedhjet e para të rregullta që Kosova mban që nga shpallja e

pavarësisë më 2008. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë me dije se numri i votuesve për zgjedhjet e 9 shkurtit do të jetë 2 milionë e 75 mijë e 868 votues brenda dhe jashtë Kosovës. Për këto zgjedhje janë certifikuar 28 subjekte politike me 1 280 kandidatë



INTERVISTË ME PLEURAT SEJDIUN

# KUVENDI I DEGRADUAR DHE KEQQEVERISJA MË NXITËN TË RIKTHEHEM NË POLITIKË

Pas një pauze të gjatë në jetën politike, doktor Pleurat Sejdiu ka vendosur të garojë për deputet në zgjedhjet parlamentare që do të mbahen më 9 shkurt. Ai është pjesë e listës së PDK-së me numrin 53. Në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Sejdiu ka treguar arsyen se çfarë e shtyri t'i rikthehet politikës dhe kandidimit për deputet. Ai, po ashtu, ka bërë me dije se çfarë i ka munguar legjislaturës aktuale të Kuvendit që po përfundon mandatin. "Këtij vendi i duhet zëri i arsyes, angazhimi i guximshëm, kompetenca dhe vendosmëria që do t'i bënin ndryshimet e nevojshme", ka thënë Sejdiu



## KOSOVA DHE SHBA-ja DO TË FINALIZOJNË MARRËVESHJE PËR DIALOG STRATEGJIK



## OPINION

### QEVERIA E BLACK FRIDAYT, PËR VOTA KLIENTELISTE!

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE



### KOMF-I UA DORËZON KANDIDATËVE PËR DEPUTETË PROPOZIMET PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE, ME THIRRJEN PËR ZOTIM DHE MBËSHTETJE

### LEJET PËR ARMË BËJNË BUM NË KOSOVË

## EKONOMI



### LANSOHET PARAKUALIFIKIMI PËR PROJEKTIN E RUAJTJES SË ENERGISË PËRMES BATERIVE

### INFLACIONI NË VITIN 2024 ISHTE 1,6 PËR QIND MË I LARTË SE NJË VIT MË PARË. NË ÇKA PATI RRIJTJE TË ÇMIMEVE?

## SPORT

### PËRBALLEN KAMPIONI DHE NËNKAMPIONI

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçishtë - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mail: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Sot zyrtarisht fillon fushata për zgjedhjet e 9 shkurtit

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Sot (e shtunë), 11 janar, subjektet politike do ta fillojnë zyrtarisht fushatën zgjedhore. Për një muaj partitë dhe kandidatët do të tentojnë t'i bindin votuesit t'i zgjedhin ata. Këto do të jenë zgjedhjet e para të rregullta që Kosova mban që nga shpallja e pavarësisë më 2008.

PDK-ja dhe LDK-ja do ta hapin fushatën të shtunën, më 11 janar, në Prishtinë, ndërkaq AAK-ja e nis fushatën me homazhe në Prekaz, ndërsa LV-ja në Gjakovë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka bërë me dije se numri i votuesve për zgjedhjet e 9 shkurtit do të jetë 2 milionë e 75 mijë e 868 votues brenda dhe jashtë Kosovës. Për këto zgjedhje janë certifikuar 28 subjekte politike me 1 280 kandidatë. Në fletëvotim votuesit do të mund të zgjedhin një subjekt politik dhe deri në dhjetë kandidatë për deputetë. Ky është një ndryshim pas miratimit të Ligjit të ri për Zgjedhjet. Në të kaluarën qytetarët kanë pasur mundësinë të zgjedhin deri në pesë kandidatë.

Secila parti e certifikuar mund të ketë deri në 110 kandidatë në listën zgjedhore.

Nga këto lista do të zgjidhet përbërja e re e Kuvendit me 120 ulëse dhe deputetët me pas zgjedhin qeverinë e re. Qeveria aktuale në Kosovë udhëhiqet nga Albin Kurti, kreu i Lëvizjes Vetëvendosje. Nga 6 janari e deri më 8 shkurt mbi 100 mijë shtetas të

Kosovës që jetojnë jashtë vendit do të mund të votojnë me postë për zgjedhjet parlamentare të Kosovës më 9 shkurt.

Policia e Kosovës, bazuar në ligjet pozitive të vendit dhe autorizimeve si agjenci kyçe për sigurinë publike në tërë territorin e vendit, ka hartuar urdhrin operativ policor me kohë dhe ka bërë të gjitha planifikimet policore lidhur me "Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës" të cilat do të mbahen më 9 shkurt.

Me qëllim të ofrimit të sigurisë dhe mbarëvajtjes së procesit zgjedhor është paraparë të angazhohet një numër i mjaftueshëm i zyrtarëve policorë kryesisht të rendit publik, por sipas nevojës mund të angazhohen edhe zyrtarë policorë të profileve të ndryshme, që iu përkasin njësitëve të ndryshme brenda Policisë së Kosovës.

Ky plan operativ ka paraparë katër faza: 1) Periudha parazgjedhore apo përgatitore vlerësuese, 2) Angazhimi në ofrimin e sigurisë gjatë fushatës zgjedhore, 3) Garantimi i sigurisë në fazën kyçe të ditës së zgjedhjeve dita (Z), 4) Periudha pas zgjedhjeve që parashihet transportin nën përcjellje dhe siguri të PK-së, të materialit sensitiv e deri në përfundim të procesit.

Faza e parë tani veçse është realizuar, përderisa tani jemi në fillim të zbatimit të fazës së dytë, për të vazhduar sipas planit me fazat e tjera, deri në përfundim të procesit zgjedhor.

Sipas planifikimeve policore,



qëllimi i këtij urdhri operativ për këtë proces zgjedhor është: Krijimi i një klime të qetë dhe të sigurt për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës si dhe mbajtja e rendit, qetësisë dhe sigurisë publike në vend para, gjatë dhe pas procesit të zgjedhjeve. Sigurimi i qendrave të votimit, këshillave komunale të zgjedhjeve, depove komunale, Qendrës së Numërimit të Rezultateve dhe depove qendrore. Përcjellja e sigurt dhe sigurimi i të gjithë materialit sensitiv zgjedhor nga të gjitha destinacionet e parapara sipas planit të sigurisë deri në përfundimin e operacionit policor, që ndërlihet me procesin zgjedhor. Inicimi dhe procedimi i çdo veprë penale

kundër të drejtës së votimit dhe ndërmarrja e të gjitha masave procedurale/penale ndaj çdokujt që bie ndesh me ligjet pozitive të vendit që rregullojnë/sanksionojnë veprimet e kundërligjshme ndaj zgjedhjeve të lira dhe demokratike në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorinë e Shtetit sipas planeve të veprimit dhe marrëveshjeve paraprake të bazuara në ligj. Policia e Kosovës, bazuar në memorandumimin e bashkëpunimit në mes të Policisë, Prokurorisë dhe KQZ-së, ka caktuar zyrtarë/hetues në të gjitha drejtoritë rajonale për trajtimin e çdo rasti të mundshëm që ndërlihet me procesin zgjedhor, nën autorizimet e prokurorëve të caktuar për këtë çështje nga

Prokuroria e Shtetit. Po ashtu, janë caktuar edhe koordinatore të Policisë me KQZ-në si dhe janë dhënë udhëzime për zyrtarët policorë lidhur me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ligjore gjatë procesit zgjedhor.

Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për realizimin e detyrave dhe përgjegjësi ligjore në mënyrë profesionale karshi qytetarëve dhe vendit si dhe të jetë transparente mbi punën dhe angazhimet policore.

Policia i ka inkurajuar qytetarët të bashkëpunojnë me Policinë e Kosovës dhe institucionet kompetente, njëherësh të raportojnë për çdo rast të kundërligjshëm që ndërlihet me sigurinë dhe procesin zgjedhor, apo edhe jashtë tyre.

## Lejet për armë bëjnë bum në Kosovë

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Gjithnjë e më shumë qytetarë të Kosovës janë duke u kthyer kah armët e zjarrit - qoftë për rekreacion, qoftë për siguri. Për tre vjet numri i lejeve të dhëna për mbajtje armësh është rritur për gati tre mijë. Të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme në vend tregojnë se vetëm gjatë vitit 2024 janë dhënë mbi 10 mijë leje të tilla. Arsyet që i çojnë qytetarët të armatosen, sipas saj, lidhen me pasionet e tyre për shenjëtari dhe gjah. Por, ekspertët e sigurisë mendojnë ndryshe - pasiguria publike, thonë ata, është ndër faktorët kryesorë. Këtë, në njëfarë mënyre, e konfirmon edhe Besniku, 25-vjeçar nga Prishtina, i cili është në procedura për sigurimin e lejes për armë. "Është e natyrshme të

ndihesh më i sigurt kur ke njohuri për përdorimin e armës dhe e ke me vete", thotë ai, duke mos dashur të identifikohet më shumë.

Radio Evropa e Lirë bisedoi me të në fund të dhjetorit në Klinikën e Psikiatrisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ku po priste t'i kryente testet psikologjike dhe psikiatrike - të nevojshme për t'u pajisur me leje për armë.

Jo larg tij priste edhe një tjetër qytetar, në mesin e të 20-tave, i cili u identifikua vetëm me emrin Leart. "Do të aplikoj për armë të shkurtër dhe armë të gjatë", tha ai. "Kam dëshirë ta mbaj armën... edhe për hobi por, normalisht, ndihem edhe më i sigurt kur e kam me vete", shtoi Learti.

Në QKUK thonë se brenda

një jave mbi 50 persona u nënshtrohen kontrolleve të psikologu, psikiatri, neurologu, oftamologu dhe otorinolaringologu, si dhe analizave biokimike - që të gjitha të nevojshme për ta kërkuar lejen e armëmbajtjes.

### Kush mund të pajiset me armë?

Me Ligjin për Armët në Kosovë çdo person që ka së paku 21 vjet mund të kërkojë leje për t'u pajisur me armë. Aplikuesi duhet të ketë aftësi psiko-fizike dhe ta kalojë testin teorik dhe atë praktik për përdorimin e armës. Po ashtu, duhet të ketë arsye të besueshme përse ka nevojë për armë, si dhe të kaluar të pastër kriminale.

Vlerësimin e bëjnë



autoritetet përgjegjëse për fushën e caktuar. Arma, edhe përkundër lejes, mund të konfiskohet me vendim gjyqësor, nëse

poseduesi humb aftësinë e veprimit, aftësinë psiko-fizike, dënohet për veprë penale ose shkel kushtet e përcaktuara.



# Kosova dhe ShBA-ja do të finalizojnë marrëveshje për dialog strategjik

Kosova dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës së shpejti do të finalizojnë një marrëveshje për dialogun strategjik. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të premten se me kërkesën e saj në vitin 2021, ShBA-ja ka konfirmuar se së shpejti do ta finalizojë këtë dialog me Kosovën. Lajmin ia ka sjellë zëvendëssekretari amerikan i Shtetit për Menaxhim dhe Burime, Richard R. Verma, i cili po viziton Kosovën

EPOKA  
ERE

M. QORRAJ

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë të premten se Kosova dhe Shtetet e Bashkuara do ta finalizojnë "së shpejti" një marrëveshje për "dialog strategjik" mes dy vendeve. Në një shkrim në "Facebook", pas një takimi në Prishtinë me zëvendëssekretarin e Shtetit për Menaxhim dhe Burime i ShBA-së, Richard R. Verma, Osmani tha se zyrtari amerikan ia konfirmoi asaj se, pas kërkesës së saj në vitin 2021, Kosova dhe ShBA-ja do ta finalizojë së shpejti "dialogun strategjik". "Pas propozimit që i kam dërguar Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si presidente e Republikës qysh në vitin 2021, pastaj rikonfirmuar në qershor të vitit 2022 nëpërmjet notës verbale si dhe në takimin me sekretarin Blinken në korrik 2022, si dhe pas një pune të jashtëzakonshme të ekipeve

tona përgjatë viteve të kaluara, sot në takim me zëvendëssekretarin amerikan Richard Verma m'u konfirmua se Kosova dhe ShBA-ja do ta finalizojë së shpejti dialogun strategjik. Kjo është një e arritur e jashtëzakonshme që dëshmon se partneriteti i mirëfilltë, i bazuar në vlera dhe interesa të përbashkëta, gjithmonë sjell rezultate. Falënderoj Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për këtë përkrahje ndaj popullit të Kosovës dhe mezi pres ta vazhdojmë bashkëpunimin intensiv në interes të Kosovës. Ekipet tona do të takohen së shpejti për ta finalizuar marrëveshjen për dialogun strategjik e cila do të përfshijë fusha shumë të rëndësishme në interes të qytetarëve të Kosovës", ka thënë Osmani. Dialogu strategjik në mes të Shteteve të Bashkuara dhe vendeve të tjera është nivel i lartë diskutimi për thellimin e partneritetit. ShBA-ja udhëheq dialog

strategjik me një numër vendesh, me qëllim të avancimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme. Ndër vendet me të cilat ShBA-ja ka dialog strategjik janë: Maqedonia e Veriut, Lituania, Mbretëria e Bashkuar, Rumania, Austria, Polonia, Sllovenia, Moldavia, Greqia, Lihtenshtajni, Katari, Omani, Bahreini, Egjipti etj. Osmani kishte biseduar për nevojën e dialogut strategjik në mes të Kosovës dhe ShBA-së edhe në tetor të vitit 2024 me të dërguarin e ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Alexander Kasanof, gjatë vizitës së tij në Kosovë. "Në

takimin me Kasanof, presidentja Osmani diskutoi edhe për mundësinë e thellimit të bashkëpunimit në fusha të ndryshme me interes të ndërsjellë, siç është fusha e mbrojtjes dhe sigurisë", tha asokohe zyra e Osmanit. Verma po e viziton Kosovën si pjesë e turit që është duke e zhvilluar në Ballkanin Perëndimor, ku të enjten qëndroi në Shqipëri, ndërsa të shtunën do ta përfundojë atë me një ndalesë në Serbi, njoftoi Departamenti Amerikan i Shtetit. Ai do të takohet edhe me komunitetin e biznesit dhe me përfaqësues të medieve gjatë qëndrimit në

Kosovë, njoftoi Ambasada Amerikane në Prishtinë. Vizita e tij po zhvillohet dhjetë ditë para se administrata Biden ta përfundojë mandatin dhe presidenti i zgjedhur, Donald Trump, të kthehet në Shtëpinë e Bardhë. Ditë më parë DASH-i tha në një njoftim se në Kosovë, Verma do të diskutonte për normalizimin e marrëdhënieve të Kosovës me Serbinë përmes dialogut të lehtësuar nga BE-ja, forcimin e qeverisjes dhe sundimit të ligjit, si dhe nxitjen e rritjes ekonomike dhe sigurisë energjetike në dobi të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

## Qeveria miraton rritjen e pensioneve për kategoritë e luftës

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Qeveria e Kosovës e ka miratuar të premten rritjen e pensioneve për të gjitha kategoritë e dala nga lufta e fundit në Kosovë, për 20 për qind. Kabineti i kryeministrit Albin Kurti e miratoi përditësimin e një aneksi në Ligjin për Kategoritë e Luftës gjatë një takimi të premten, për ta mundësuar rritjen e premtuar tetorin e kaluar. "Siç patëm njoftuar në tetor, sot, edhe zyrtarisht, do të aprovohet rritja për 20 për qind mbi shumën aktuale për familjet e dëshmorëve, invalidët, veteranët, pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimat e dhunës seksuale dhe viktimat civile", tha Kurti. Ministri i Financave i Kosovës, Hekuran Murati, tha se rritja për të gjitha kategoritë e veteranëve, invalidëve dhe viktimave të dhunës seksuale do të jetë 20 për qind mbi shumën e tanishme pensionale. Për disa kategori ka rritje edhe përtej shkallës prej 20-

përqindësh, tha ministri. Kategoritë që përfitojnë rritje mbi 20 për qind janë familjet e dëshmorëve të UÇK-së që kanë dy dëshmorë ose më tepër, familjet e të zhdukurve të UÇK-së që kanë mbi dy të zhdukur dhe familjet e viktimave civile, tha ai. Me rritjen e re, Murati tha se familja që ka një dëshmor luftë do t'i marrë 537 euro në muaj, familja që ka dy dëshmorë luftë do t'i përfitojë 806 euro, familja që ka tre dëshmorë do të marrë pension mujor prej 1 075 eurosh, ndërsa jo që ka katër dëshmorë luftë 1 344 euro. Skema e pensioneve për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës sipas kategorive përfshin 12 681 përfitues, sipas Agjencisë Kosovare të Statistikave (ASK). Kjo është rritja e parë në 10 vjetët e fundit për këto kategori, prej kur ishin bërë këto skema më 2014, tha ai. Rritja do të vlejë nga ky muaj, theksoi ministri Murati në një konferencë për medie. Viktimat e dhunës seksuale të



luftës deri tani kanë marrë pension në vlerë prej 230 eurosh, dhe me rritjen e re të premten, ato do të gëzojnë pension prej 276 eurosh. Numri i saktë i viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në

Kosovë nuk dihet. Sipas një raporti të Qendrës Amerikane për Kontrollimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve, kjo shifër arrin deri në 20 mijë. Pensioni i veteranit ka qenë 170 euro deri tani, por me rritjen

prej 20-përqindësh, një veteran do t'i marrë 204 euro pension mujor. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 37 006 persona janë përfitues nga skema për veteranët e luftës.





INTERVISTË ME PLEURAT SEJDIUN

# Kuvendi i degraduar dhe keqgeverisja më nxitën të rikthehem në politikë

Pas një pauze të gjatë në jetën politike, doktor Pleurat Sejdiu ka vendosur të garojë për deputet në zgjedhjet parlamentare që do të mbahen më 9 shkurt. Ai është pjesë e listës së PDK-së me numrin 53. Në një intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Sejdiu ka treguar arsyen se çfarë e shtyri t’i rikthehet politikës dhe kandidimit për deputet. Ai, po ashtu, ka bërë me dije se çfarë i ka munguar legjislaturës aktuale të Kuvendit që po përfundon mandatin. “Këtij vendi i duhet zëri i arsyes, angazhimi i guximshëm, kompetenca dhe vendosmëria që do t’i bënin ndryshimet e nevojshme”, ka thënë Sejdiu

Në një intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, Sejdiu ka treguar arsyen se çfarë e shtyri t’i rikthehet politikës dhe kandidimit për deputet. Ai, po ashtu, ka bërë me dije se çfarë i ka munguar legjislaturës aktuale të Kuvendit që po përfundon mandatin. “Këtij vendi i duhet zëri i arsyes, angazhimi i guximshëm, kompetenca dhe vendosmëria që do t’i bënin ndryshimet e nevojshme”, ka thënë Sejdiu. Në këtë intervistë Pleurat Sejdiu ka folur edhe për PDK-në dhe Gjykatën Speciale, gjithashtu edhe për fitoren që ky subjekt politik do ta

ngadhënjë më 9 shkurt.

**“Epoka e re”:** Z. Sejdiu, ka më se 20 vjet që kur jeni larguar nga marrja aktive me politikë. Sa ishte i rëndë rikthimi në politikën aktive dhe çfarë ju shtyri të merrni këtë vendim?

**Pleurat Sejdiu:** E di se rikthimi im në politikë për shumë kë ka qenë befasi. Ishte vendim jo i lehtë, por situata e përgjithshme në Kosovë, Kuvendi politikisht dhe moralisht i degraduar, mbajta e çlirimtarëve në Hagë, përdhosja sistematike e vlerave dhe trashëgimisë së UÇK-së, janë ndër arsytet politike që më

kanë nxitur në këtë vendim. Në kohën kur Kosova po keqgeveriset, si rrjedhojë jeta e qytetarëve po vështirësohet e sidomos e të rinjve, kohë kur çlirimtarët po sulmohen, vlerat më sublimë po përdhosen, ndërsa e ardhmja europerëndimor po rrezikohet, çdo shqiptar i përgjegjshëm dhe i ndërgjegjshëm nuk mund të qëndroj indiferent. Ky vendim imi ka hasur në përkrahje të PDK-së, gjë që më ka nderuar pa masë. Konsideroj se të gjithë ata që kanë hise në lirinë e këtij vendi duhet të ndihen përgjegjës që ende Kosova s’po arrin të konsolidohet si shtet. Të keqes duhet t’i dilet përpara në çdo kohë dhe me të njëjtin guxim dhe përgjegjësi.

**“Epoka e re”:** Ju njiheni se jeni ndër njohësit më të mirë të problemeve në shëndetësi. Gjendja aktuale, a ka ndikuar në marrjen e këtij vendimi?

**Pleurat Sejdiu:** Sigurisht po, por edhe zëri i mekur apo inekzistent i profesionistit shëndetësor në Kuvendin e Kosovës, stigmatizimi i

**EPOKA ERE**

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Pas një pauze të gjatë në jetën politike, doktor Pleurat Sejdiu ka vendosur të garojë për deputet në zgjedhjet parlamentare që do të mbahen më 9 shkurt. Ai është pjesë e listës së PDK-së me numrin 53.

Pleurat Sejdiu është një nga themeluesit e PDK-së. Pos punës në profesionin e tij - mjek kirurg - ortoped brenda dhe jashtë vendit, ka pasur shumë funksione të

rëndësishme në skenën publike si përfaqësues diplomatik i UÇK-së, zëvendësministër i Punëve të Jashtme në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës, bashkëdrejtues i Departamentit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në kohën e UNMIK-ut, sekretar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe ka bartur pozita të tjera në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe institucioneve të tjera. Ndërkaq aktualisht është kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës.



# QEVERIA E BLACK FRIDAYT, PËR VOTA KLIENLISTE!



Behxhet Sh.  
SHALA - BAJGORA

**Nuk pyetet për çmim të votave:** Kjo qeveri po përfundon për faqe të zezë, pa asnjë investim kapital përveç përfitimit personal. Gjatë këtij mandati të plotë ka vetëm përkeqësim ekonomik që ka prodhuar një paqëndrueshmëri sociale. Llogaritet se inflacioni për këtë mandat është 22 për qind, ndërkaq që pensionet, ato civile dhe të luftës u rritën, krejt në fund të mandatit 20 për qind pa e bërë fare indeksimin e çmimeve. Kjo nënkupton që pensionistët nuk e marrin as pensionin bazë që e kishin në fillim të mandatit të kësaj qeverie kleptokratike (hajdute, të korruptuar). Pastaj, çmimet e artikujve të domosdoshëm për mbijetesë janë rritur thuaja 100 për qind, kurse rryma dhe nxemja faturohen për standard suedez e jo për standard kosovar që nuk është as në nivelin e Bangladeshit. Faturat e fundit të rrymës të faturuara nga Marrin Berishaj dhe ato të nxehjes të lejuara nga organizata e strukturuar kriminale e quajtur KOST, i kanë futur shumicën e qytetarëve në kredi konsumuese në kohën kur në shtetet evropiane ka tendencë të uljes së çmimeve të rrymës dhe nxemjes. Qytetari kosovar paguan më shumë para për

rrymë dhe nxemje se qytetari amerikan. Në Kosovë vetëm faturat për ujë dhe mbeturina janë të përballueshme. Ta bëjmë një krahasim midis qeverive në Maqedoni të Veriut dhe të Kosovës. Qeveria e Kosovës në fund të mandatit i rriti pensionet e të gjitha skemave 20 për qind, që nënkupton shumë midis 35 deri 40 euro. Kjo është e vetmja rritje për 4 vjet, hiç këtu vitrat e kriminelit social Murati nga 100 euro. Qeveria e Maqedonisë së Veriut, menjëherë pasi mori mandatin, rriti pensionet për 5000 denarë (83 euro) kurse, së dyti, para një jave i rriti përsëri me 5000 denarë (83 euro). Pra brenda 6 muajve i rriti pensionet për 166 euro, duke bërë përpjekje t'i ndihmojë qytetarët në nevojë pa bërë kalkulime klienteliste. Rritja e pensioneve të të gjitha skemave, krejt në fund të mandatit, është veprim klientelist për blerje të votave dhe pandershmëri njerëzore dhe institucionale, dhunim i buxhetit të Kosovës dhe përpjekje për të mbetur në pushtet duke keqpërdorur taksat e qytetarëve. Po qytetarët duhet të jenë të kujdesshëm para kutive të votimit, me vota klienteliste nuk duhet të bëhen pjesë e skemës kriminale të shitblerjes së votave. Ata kanë merituar shumë më tepër dhe kjo që iu ofrohet është termi, lëshues dhe kushtëzuar me votë. Qytetarët duhet të jenë të kujdesshëm edhe ndaj premtimeve statusferike për rritje të pagave dhe pensioneve që po i bëjnë disa politikanë e që, në buxhetin ekzistues, do të jetë misioni

pamundur. Peci i Albinit, në grahamat e fundit të pushtetit, po i ndan edhe disa grante për partitë që janë në pushtet, gjykatat, cicat dhe prapancat e partisë mos, ndoshta, e fiton edhe një mandat, ky mbiemër i vogël, por llaskuq i madh.

**Sa ndikon kjo në rezultatin e zgjedhjeve:** Në Ballkan klientelizmi thuaja e përcakton fituesin duke e bërë diferencën midis arsyes dhe mashtrimit, ecjes përpara dhe prapakthimit, zhvillimit dhe degradimit, ndershmërisë dhe poshtërsisë, qytetarisë dhe nacionalizmit folklorik, atdhedashurisë dhe dëmtimit të interesave të Kombit dhe shtetit. Albin Kurti është virtuoz në këto lojëra sepse ka mungesë totale të empatisë, atdhedashurisë dhe nacionalizmit i ka hibride, bashkimin kombëtar e ka dhunuar, nuk ka asnjë flamur dhe çdo gjë e vë për interes të pushtetit. Ndjenja dhe dëshira për autokraci, sundim mbi njeriun, poshtërim të njeriut, shpërfillje dhe mosmirënjohje kalojnë në patologji, prej vesit janë shndërruar në degjenerim. Pasioni për të mbrojtur çdo hajn të vetin dhe për t'i sulmuar, deri në asgjësim hajnat tjerë (mendon te opozita), nuk është larg çmendisë. Albin Kurti refuzon të shkojë në Prokurori, jo se është najfarë trimi por se e bënë vetëm për vota. Unë e them se votat e këtyre votuesve nuk i duhen asgjë, vetëm e dëmtojnë. Po të shkonte në Prokurori që në ftesën e parë do të harrohej kjo punë dhe do të fitonte më shumë vota, vota të atyre që e duan shtetin, i respektojnë

ligjet dhe Kushtetutën. Edhe Sali Berisha nuk lajmërohet në Prokurori, vetëm pasi bëri më shumë se një vit këndim në dritaren e banesës së tij, tash me kohë lajmërohet para Prokurorisë. Albini nuk i ka gjykatat e Hamdisë e as koç... e Pecit me hy në luftë me media, Prokurori, Gjykata, BE-në dhe Amerikën. Matematika e përimtësuar zgjedhore që është duke e bërë Albini, mund t'i sjellë shumë vota por edhe ta lë me gishta në gojë. Përzgjedhja selektive e mediave duke shkuar te Shtëpia Pornografike Informative ku Makro i këtij prostitucioni dezinformativ është Rilindi, te pasardhësi politik i Arkanit dhe Hajni i parave të Bacë Adem Demaçit dhe te naj medium i grazhdit qeveritar, vetëm sa e shemb Albinin, nuk e rritë fare. Albini nuk pranon debate me kandidatët e opozitës sepse përballë tyre sillet si Zeusi dhe nuk ka asnjë mënyrë të mbrojtjes të pambrojturën, ta mbrojë hajninë, nepotizmin dhe kapjen e çdo gjëje që ka arritur të kap. Albini e ka kabinetin qeveritar një tufë injorantësh, brutalisht të pazotë dhe të padenjë dhe, me gjithë elokuencën dhe retorikën, e ka të pamundur t'i mbrojë. Prandaj nuk shkon as vet dhe nuk e dërgon askënd, nuk ka kënd ta dërgojë. Ndoshta ia vlen t'i dërgojë intelektualë dhe eruditë të shquar si Agim Bahtirin, Mefin, Dimalin, Halilin, ekstazitë e Prizrenit, pecin personal, Krrakin, Pozharnin, Binak Maxharrajn që konsiderohen, pa modesti ajka e mendimit akademik dhe politik. Albin Kurti e ka çështje të

mbijetesës politike dhe fizike edhe një mandat prandaj nuk zgjedhë mjete për ta realizuar këtë qëllim. Nëse me partnerin tradicional, Listën Serbe nuk e formon qeverinë, do të bëjë koalicion me drejtin dhe të birin për një mandat tjetër. Dhe, mund t'ia dalë sepse nuk besoj te refuzimi i partive opozitare të mos hyjnë në bashkëjetesë me këtë kompleksitet indesh i quajtur Albin Kurti. Për Albinin më i rëndë është 20 janari se 9 shkurti, 20 janari e kushtëzon 9 shkurtin.

**Përbërja e Kuvendit:** Nëse Albini nuk siguron vota për formim të qeverisë, do ta bllokojë edhe formimin e Kuvendit, nëse del si parti fituese duke shkuar nga kriza në krizë. Nëse nuk ndërhyjnë arbitri ndërkombëtar. VV, PDK, LDK, AAK - NISMA dhe Koalicioni për Familje, besoj se do të jenë në Kuvendin e ardhshëm, bashkë me LS dhe pakicat joserbe. Votat do të shpërndahen, dallimi midis vendit të parë, dytë dhe tretë nuk do të jetë shumë i madh. AAK - NISMA do të fitojë midis 10 dhe 13 për qind. Të shohim si do të zhvillohen gjërat dhe a po e vendosë Albin Baba, kufirin te Molla e Kuqe. Një militant budalla i Albin Babës tha se po ta linin ndërkombëtarët, ky, bashkë me Komandant Pasulin, Hysen Dezertorin, Kaçketën e Bllacës dhe pordhaxhinjtë virtualë, për katër orë do ta shkelte Beogradin. Fort i ka marrë malli për Serbinë dhe Beogradin, jo vetëm zemlaken e Radoiçiqit, Limoza Kularin - Gadafi.

profesionistit shëndetësor, në veçanti nga ana e politikës qeveritare në katër vjetët e fundit, por jo vetëm, ishte arsyeja tjetër për rikthimin tim në politikë. Besoj se është e papranueshme, me një përjashtim, nuk kemi dëgjuar zërin e deputetëve nga profesionet mjekësore të ngrehin zërin në Kuvendin e Kosovës për problemet e vet profesionistëve, votuesve të tyre të para katër viteve. Mendoj se e gjitha kjo ndodh për arsye të mungesës së kuadrit dhe kompetencës qeverisëse, ku institucionet janë shndërruar në çerdhe nepotizmi, militantësh dhe të paditurish.

**"Epoka e re":** Ju mendoni se kjo gjendje mund të ndryshojë me këto zgjedhje?

**Pleurat Sejdiu:** Në këtë situatë, gati të pashpresë, për ta përballur të keqen me të vërtetën dhe daljen nga

dëshpërimi, duke rivendosur shpresën e perspektivës, sidomos në fushën e shëndetësisë dhe arsimit por, jo vetëm, si pika më të ndjeshme të shoqërisë, ku brengat nuk dëgjohej mjaftueshëm, as meritueshëm në institucionet përgjegjëse, veçanërisht në tempullin ligjvënës, i cili, për fat të keq, është shndërruar vetëm në makineri votimi, shpeshherë antikushtetuese dhe të mbulimit të kundërligjshmërisë. Unë besoj më shumë se kurrë, se këtij vendi i duhet zëri i arsyes, angazhimi i guximshëm, kompetenca dhe vendosmëria që do t'i bënin ndryshimet e nevojshme.

**"Epoka e re":** Si e gjetët PDK-në pas kaq vitësh? Sa ka ndryshuar?!

**Pleurat Sejdiu:** PDK-ja ka pësuar goditje të rëndë nga Gjykata Speciale, e cila ka goditur themelet tona. Pa

marrë parasysh goditjet, forca dhe shpirti luftarak i PDK-së mbijeton. Parimisht, si në çdo organizim serioz, ripërtëritjet organizative janë proces i nevojshëm, gjeneratat ndryshohen natyrshëm dhe, po ashtu, ndërlihdja e gjeneratave duhet të ruhet si transferim dhe ruajtja e memories dhe frymës që e kanë brumosur kuadrot e UÇK-së dhe ilegales të viteve '80 dhe '90. Mendoj se PDK-ja ka kuadro të reja që do ta sigurojnë gjenin themeltar të PDK-së.

**"Epoka e re":** Qëndrimi juaj për Gjykatën Speciale?

**Pleurat Sejdiu:** Gabim dhe mashtrim!

**"Epoka e re":** Besoni në fitore më 9 shkurt?

**Pleurat Sejdiu:** Ata që iu qasen betejave në kohë të vështira, edhe besojnë në fitore. Prandaj jemi të sigurt se dielli do të lindë prapë.





# Çfarë na bën ajri i ndotur?

Pas ndotjes së ajrit nga fishekzjarrët për Vitin e Ri, dhe nisjes së fushatës “Kryeqyteti pa makina” në Prishtinë, vëmendja është kthyer sërish në problemin e kamotshëm të Kosovës, e sidomos kryeqytetit: ndotjen e ajrit. Në fushatë bëhet thirrje për zvogëlim të përdorimit të makinave, por problemi është edhe më i thellë, faktorët e ndotjes janë të shumtë. Si ka ndryshuar situata ndër vite?

**PRISHTINË, 10 JANAR** - “Një minutë i makinës së ndezur mbush 150 tullumbace me gazra të dëmshme”. Ky është vetëm një prej mbishkrimeve në tabelat e vendosura ditët e fundit në Prishtinë me qëllim të vetëdijesimit të qytetarëve që t’i braktisin makinat dhe të ecin këmbë. Këto tabela janë një tjetër rikujtim për qytetarët e Kosovës se në çfarë ajri jetojnë. Çdo vit në sezonin e dimrit atyre u shtohet edhe ky hall: çfarë ajri po thithin?

Ndotja e ajrit përbën ndër kërcënimet kryesore për shëndetin e njeriut, ka thënë Organizata Botërore e Shëndetësisë [OBSH]. Sipas saj, 99 për qind e popullsisë botërore jeton në zona ku nuk përmbushen standardet për kualitet të ajrit.

Grimcat PM 2.5 që përhapen në ajër kanë ndikimin më të keq në shëndetin e njeriut. Grimcat [PM 2.5 dhe 10] janë shumë të imëta, dhe për shkak të peshës së vogël qëndrojnë lehtë në ajër, prandaj depozitohen lehtë në organizmin e njeriut përmes ajrit të thithur.

Sipas të dhënave të Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës - përgjegjës për monitorim të cilësisë së ajrit - më 2024 janë regjistruar 32 ditë me ndotje të ajrit mbi standardin e përcaktuar nga Agjencia Evropiane e Mjedisit - pra 32 ditë kur grimcat e ajrit PM 10 kanë qenë mbi nivelet e lejuara, në krahasim me 120 ditë më 2010. “Standardi i lejon vetëm 35 ditë. Ne e kemi

ulur ndotjen, por kursesi nuk jemi të kënaqur që të kemi tejkalime. Qoftë edhe nëse një ditë, një orë, kemi tejkalim të standardit, për neve është e papranueshme”, ka thënë Shkumbin Shala, specialist i cilësisë së ajrit në Institutin Hidrometeorologjik të Kosovës, në disa përgjigje për “Radion Evropa e Lirë”. Sipas tij, periudha më kritike e ndotjes së ajrit në Kosovë është prej nëntorit deri në shkurt.

## Kush janë ndotësit më të mëdhenj të ajrit?

Bloqet në termocentralin ekzistues të Kosovës A, kompanitë e mëdha sikurse Feronikeli, mbetjet e gjigantit metalurgjik Trepça, sektori i mbeturinave, sektori i transportit, ekonomitë familjare, mungesa e gjelbërimit dhe sektori i ndërtimitarisë në zonat urbane, konsiderohen shkaktarët më të mëdhenj të ndotjes, sipas Shalës.

Sipas një raporti të Bankës Botërore të vitit 2019, kosovarët dhe popujt që jetojnë në Ballkan dhe Evropën Lindore, thithin më shumë grimca toksike sesa fqinjët në Evropën Perëndimore, dhe kjo edhe për shkak të më pak politikave për reduktim të ndotjes së ajrit dhe ngrohjes dhe gatimit duke përdorur lëndë djegëse të ngurta [shporete me dru dhe qymyr].

Ngjashëm edhe në raportin e vitit 2024 të OBSH-së - për

ndotësit e ajrit brenda ambienteve shtëpiake në Kosovë - përmendet se ndër burimet kryesore të ngrohjes për ekonomitë familjare në Kosovë është stufa me dru, si kërcënim real për shëndetin e njeriut, përfshirë edhe tymosjen e cigares në ambiente të brendshme.

Institucionet shëndetësore në botë vlerësojnë se ajri i ndotur shkakton probleme në sistemin e frymëmarrjes, kancer në mushkëri, bronkit, astmë, sëmundje kronike të mushkërive, probleme në sistemin kardiovaskular, probleme neurologjike, ndikon në zhvillimin e trurit të fëmijëve, në sistemin riprodhues, dhe në probleme me lëkurën.

Personat e moshuar, gratë shtatzëna, personat me sëmundje kronike, si dhe të varfrit si kategori sociale, thuhet se e vuajnë më së rëndi ajrin e keq të një vendi.

## Vdekjet e parakohshme

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKSHPK) i ka thënë Radios Evropa e Lirë se 1 150 vdekje në vit i atribuohen cilësisë së keqe të ajrit, çka paraqet 12.1 për qind të vdekshmërisë totale nga të gjitha shkaqet natyrore.

Instituti ka thënë se këto të dhëna i mbështet në studimin e kryer nga projekti Millennium Challenge Cooperation në periudhën 2017-2019 në Kosovë. Institucionet e tjera kanë të



dhëna të tjera.

Sipas raportit të Bankës Botërore, rreth 760 njerëz vdesin para kohe çdo vit në Kosovë për shkak të ekspozimit në ajër të ndotur.

Sipas Agjencisë Evropiane për Mjedis, numri i vdekjeve të parakohshme nga ekspozimi në nivele të dëmshme të grimcave PM 2.5 është ulur nga 3.888 në 2005, në 2.608 më 2021.

Më keq se Kosova, në nivel rajonal, janë Maqedonia e Veriut dhe Serbia.

Shkumbin Shala ia ka atribuuar këtë ulje adoptimit të praktikave të mira prej vendeve që veçse e kanë tejkaluar këtë fazë të ndotjes së ajrit.

Ai ka përmendur investimin e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) më 2013 për mbulimin e deponisë së hirit, shtrirjen e ngrohtores përmes KEK-ut në Prishtinë, si dhe vetëdijesimin e një pjesë të qytetarëve për dëmet e djegies së thëngjillit apo druve. “Në vjetët e fundit kjo ulje nuk vërehet në masë të rënies drastike, siç ka ndodhur në të kaluarën, pasi investimet e mëdha janë bërë, tani na duhen investime të vogla, me korrigjime në zonat urbane,

te pjesa e ndërtimit, te pjesa e bizneseve. Ndoshta komuna mund ta menaxhojë më mirë që disa biznese si, restorante, autolarje e servisime që nuk janë të nevojshme në qendër të qytetit, të largohen në periferi”. Shala rekomandon se për përmirësim të mëtejme të situatës, duhet të shtyhet përpara përdorimi i energjisë së rinovueshme, të përmirësohet sistemi i transportit publik, të ketë kontroll të emetimeve industriale dhe të ketë fushata ndërgjegjësimi për mbështetje të politikave mjedisore.

## Çfarë mund të bëjë gjithsecili?

Autoritetet sugjerojnë se në ditët kur ajri është i cilësisë së dobët, nuk rekomandohet të dilni në ambiente të hapura nëse nuk është e domosdoshme, apo të përdorni maskat e tipit N95. Por, ajo që mund të bëni për ruajtje të ambientit përfshin mosdjegien e druve, qymyrit apo peletit, ta reduktoni harxhimin e rrymës, ta shmangni makinën dhe të ecni apo ta përdorni biçikletën.

# Kurti: 2025-a do të jetë vit i gruas në Kosovë

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Kryeministri Albin Kurti ka thënë se viti 2025 do të jetë vit i gruas në Republikën e Kosovës. “Në mandatin tonë të parë kemi marrë hapa e vendime të shumta që ndikojnë për të mirë në jetën dhe punën e vajzave dhe grave. Mbi 12 mijë gra janë punësuar me mbështetje direkte të qeverisë. 51 % e të rinjve përfitues të platformës së punësimit SuperPuna janë vajza. 55 % e përfituesve të masës së punësimit ‘Qeveria për familjet’ janë gra. I kemi mbështetur mbi 60 mijë nëna lehonat me shtesa për to dhe për fëmijët të sapolindur. Rreth 100 mijë gra kanë hapur për herë të parë llogaritë e tyre bankare. Me qeverisjen tonë përfaqësimi i grave në ndërmarrje publike dhe administratë publike është rritur shumë. Ndërkaq, përmes masave e politikave tona mbështetja për të është rritur theksueshëm edhe në ndërmarrësi, bujqësi, arsim, shëndetësi dhe qasje në pronë”, ka thënë Kurti të premten.

Ai ka shtuar se ky zotim është për angazhim që vazhdon e shtohet për fuqizimin ekonomik e shoqëror të grave përmes mundësive të reja që rrisin pjesëmarrjen e tyre aktive në tregun e punës. “Këtë vit, pra në vitin 2025, do të punojmë edhe më shumë për ta rritur qasjen e grave në pronë dhe trashëgimi, duke i ndërgjegjësuar për të drejtat e tyre pronësore e trashëgimore. Angazhimi ynë për barazi gjinore do të përfshijë politika që zvogëlojnë hendekun gjinor në institucionet publike dhe sektorët profesionalë. Do të përkushtohemi edhe më shumë në arsimimin e vajzave dhe grave. Sikurse edhe në shëndetin e tyre, veçanërisht në fushën e shëndetit riprodhues dhe mendor, duke garantuar qasje në shërbime cilësore, të përballueshme dhe të barabarta”, ka thënë ai. Kryeministri Kurti ka pohuar se prioriteti i rëndësishëm mbetet mbrojtja e grave dhe vajzave nga çdo formë dhune, me theks



të veçantë në dhunën në familje dhe dhunën seksuale. “Ne tashmë e kemi miratuar strategjinë shtetërore për mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore, si dhe kemi krijuar mekanizma për ndihmë juridike falas, për strehim dhe për rehabilitim të viktimave. Është përgjegjësi e gjithsecilit që gratë dhe vajzat të jetojnë në një mjedis të sigurt, pa frikë dhe pa asnjë formë kërcënimi. Koncepti i

emancipimit dhe i fuqizimit të grave, në atë të cilën ne besojmë dhe për të cilën ne punojmë përditë, nuk është i ndërlidhur me ndërtimin e imazheve artificiale për promovimin e grave si raste të ndonjë shkëndije të rrallë suksesi. Përkundrazi, është premtimi dhe dedikimi ynë që t’i njohim e t’i kundërshtojmë pabarazitë, diskriminimet dhe pengesat të cilat të gjitha gratë i përjetojnë në përditshmëri në shoqërinë

tonë, që jo rrallëherë i kanë parandaluar ato t’i jetësojnë e përjetojnë sukseset meritore”, ka deklaruar Kurti.

Andaj, ai ka thënë se viti 2025 do të jetë vit i inkurajimit të të gjitha grave dhe vajzave për të qenë lidere në çdo fushë - në politikë, arsim, edukim, shkencë, art, kulturë e sport. “Për këtë do të vëmë në dispozicion të gjitha mekanizmat shtetërorë për ta rregulluar ekuilibrin e mirëqenies së grave në sferën private e publike, me më shumë kopshte publike për fëmijë, shërbime cilësore të arsimit publik, shërbime cilësore të shëndetësisë publike dhe mundësi të reja të punësimit. Kështu bashkë do ta rrisim pjesëmarrjen e gruas në shoqëri, jo vetëm përfshirjen e saj. Pjesëmarrja si raport i marrëdhënies, ku gratë japin dhe përfitojnë. Japin kontribut në zhvillimin dhe progresin tonë shoqëror, dhe përfitojnë nga po ai zhvillim dhe progres”, është shprehur Kurti.



# KOMF-i ua dorëzon kandidatëve për deputetë propozimet për mbrojtjen e fëmijëve, me thirrjen për zotim dhe mbështetje

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF ka nisur fushatën për të gjetur "Mbrojtës të të drejtave të fëmijëve" në mesin e kandidatëve për deputetë që kandidojnë për zgjedhjet nacionale të 9 Shkurtit 2025.

Fushata u bënë thirrje kandidatëve për deputetë nga të gjitha subjektet politike t'i bashkohen propozimit të KOMF për krijimin e "Grupit të Deputetëve për Fëmijë" dhe të mbështesin politikën e fokusuar në mirëqenien e fëmijëve. "Mirëqenia e çdo fëmije në Kosovë është çështje ndërpartiake dhe duhet të jetë prioritet për Kuvendin. Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet të jetë garantuesi kryesor i mundësive më të mira për çdo fëmijë. Prandaj u bëjmë thirrje kandidatëve për deputetë të bëhen mbrojtës të të drejtave të fëmijëve, ta nënshkruajnë deklaratën që angazhohen t'i mbështesin fëmijët në Kosovë dhe me të cilën do të jenë pjesë e 'Grupit të Deputetëve për Fëmijë' pas zgjedhjeve të 9 shkurtit. Grupi joformal synon të mbledhë deputetë nga parti të ndryshme politike, të cilët ndajnë qëndrimin se politikën për fëmijët dhe familjet duhet të jenë prioritet", ka njoftuar KOMF.

Me nismën "Grupi i Deputetëve për Fëmijë", Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve bën thirrje për konsensus dhe punë konstruktive ndërmjet deputetëve të Kuvendit dhe shoqërisë civile. "Ne besojmë se së bashku mund të arrijmë ndryshime pozitive në politikën për fëmijët dhe familjet dhe do të vazhdojmë të punojmë drejt këtij qëllimi", thuhet në njoftimin e KOMF-it.

## Cilat janë problemet?

30 % e popullsisë së përgjithshme në Kosovë janë fëmijë. Varfëria e fëmijëve vazhdon të jetë e lartë. Vdekshmëria e foshnjave dhe fëmijëve në Kosovë është trefishi i mesatares së Bashkimit Evropian, dhe më e larta në rajon. Vetëm 15 % e fëmijëve të moshës 3 - 4 vjeç marrin pjesë në programe të edukimit të hershëm. Gjatë vitit 2023 janë raportuar gjithsej 634 fëmijë pa kujdes prindëror. Kalueshmëria në testin e arritshmërisë për vitin 2023 ishte vetëm 52.1 %, ndërkaq "PISA" e ka renditur Kosovën në vendin e 76 nga 80 vende pjesëmarrëse, duke shënuar rezultate të ulëta në cilësinë e arsimit. Vetëm 10 % e fëmijëve me aftësi të kufizuara përfitojnë nga shërbimet cilësore shëndetësore, sociale dhe arsimore. Gjysma e shkollave në Kosovë nuk kanë

qasje për fëmijët me aftësi të kufizuara. Shpenzimet për shërbimet shëndetësore për fëmijët mbesin të larta.

Vlerësohet se numri i përgjithshëm i përdoruesve të drogave ka kaluar shifrën prej 30 000, ndërkohë që fëmijët dhe adoleshentët përdorues vazhdojnë të bëjnë pjesë çdo vit e më shumë në këtë shifër. Jashtëzakonisht shqetësues mbetet fakti që moshë mesatare e fillimit të përdorimit të drogave është në rënie, ku nga 18 vjeç në vitin 2018, në 16 vjeç në periudhën e fundit. Numri i kërkesave nga fëmijët për shërbime të shëndetit mendor është rritur, përdoruesve të profesionistëve të shëndetit mendor është tejet i kufizuar për t'i përballuar kërkesat dhe për të ofruar shërbime cilësore. Vetëm 7 psikiatër për fëmijë dhe adoleshentë janë në nivel vendi dhe vetëm 10 specialistë të psikologjisë klinike në nivelin dytësor dhe tretësor shëndetësor. Delikuenca e të miturve është në rritje, ku 1 867 kallëzime penale të kryesve të mitur të veprave penale ishin në vitin 2023.

## Cilat janë zgjidhjet?

Kandidatët për deputetë mund të kontribuojnë me punën e tyre për t'i mbështetur politikën në favor të fëmijëve dhe familjeve në Kosovë, sikurse: 1. Krijimin e

politikave dhe rritjen e investimeve për zhvillimin e një sistemi të mbrojtjes sociale proaktiv dhe gjithëpërfshirës për të gjithë fëmijët pa dallim. 2. Zbutjen e varfërisë dhe luftimin e përjashtimit social mes fëmijëve dhe familjeve. 3. Ndryshim-plotësimin dhe miratimin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal për krijimin e Grantit të Veçantë për Shërbime Sociale për sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve sociale për fëmijët e cenusëshëm. 4. Krijimin e sistemit të integruar për zhvillimin në fëmijërinë e hershme dhe rritjen e investimeve për rritjen e shkallës së përfshirjes së fëmijëve. 5. Monitorimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, fuqizimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve për të mbrojtur në mënyrë efektive të gjithë fëmijët nga dhuna, abuzimi, punët e rënda, trafikimi, etj. 6. Zhvillimin e politikave për fuqizimin e prindërve për kujdesin cilësor të fëmijëve. 7. Rritjen e investimeve për rritjen e cilësisë në arsim, sigurimin e gjithëpërfshirjes në shkolla dhe parandalimin e braktisjes dhe dhunës. 8. Sigurimin e zbatimit të Ligjit për Sigurime Shëndetësore, Listës Esenciale të Barnave dhe rritjen e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për fëmijët. 9. Rritjen e burimeve njerëzore brenda institucioneve publike shëndetësore për shëndetin

mendor të fëmijëve dhe themelimin e shërbimeve dhe programeve parandaluese dhe rehabilituese për trajtimin e fëmijëve përdorues të substancave narkotike. 10. Miratimin e Projektligjit për të Drejtat, Vlerësimin, Trajtimin dhe Njohjen e Statusit, Shërbimet dhe Përfitimet për Personat me Aftësi të Kufizuara për sigurimin e shërbimeve dhe mbështetjes për fëmijët me aftësi të kufizuara. 11.

Fuqizimin e sistemit të drejtësisë për fëmijët me qëllim parandalimin e delikuençës dhe rehabilitimin e të miturve në konflikt me ligjin.

Duke nënshkruar këtë deklaratë, secili kandidat për deputet, përveç 11 pikave të lartcekura, duhet të marrë përsipër që në mandatin e tij/saj të zotohet që do: Të jetë iniciues i themelimit të Grupit të Deputetëve për Fëmijë në Kuvendin e Republikës së Kosovës; Të jetë mbrojtës për të drejtat e fëmijëve si pjesë e "Grupit të Deputetëve për Fëmijë" dhe të veprojë në interesin më të mirë të tyre; Të ketë dialog dhe bashkëpunim konstruktiv me deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për çështjet e fëmijëve; Të sigurojë dialog me shoqërinë civile për çështjet e të drejtave të fëmijëve dhe mbështetjen e familjeve; Të kërkojë përfshirjen dhe konsultimin e fëmijëve dhe të rinjve dhe të dëgjoj zërin e tyre.

## Kryesuesi dhe anëtarët e KQZ-së presin në takim misionin vëzhgues të zgjedhjeve nga BE-ja

**PRISHTINË, 10 JANAR** - Një delegacion i Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve nga Bashkimi Evropian, i cili do t'i vëzhgojë nga afër zgjedhjet për Kuvendin

e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 9 shkurt 2025, qëndroi të premtën në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Fillimisht delegacioni i MVZ nga BE-ja, i kryesuar nga zëvendësi i këtij misioni, Thomas Boserup, u takua me kryesuesin e KQZ-së, Kreshnik

Radoniqi, ndërkaq më pas u takua edhe me anëtarët e KQZ-së, Sami Kurteshi, Ilir Gashi, Alban Krasniqi dhe Ibrahim Selmonaj.





## Kosova kalon me sukses Scorecardin e MCC-n për vitin fiskal 2025

PRISHTINË, 10 JANAR - Kosova ka kaluar me sukses Scorecardin e Korporatës së Sfidave të Mijëvjeçarit (MCC) për vitin fiskal 2025, duke u renditur ndër 26 shtetet nga 76 gjithsej që përmbushën këtë vlerësim të rëndësishëm. Lajmi i është konfirmuar ministres Artane Rizvanolli nga

drejtori i MCC-s për Kosovën, Rinor Gjonbalaj. Scorecardi mat performancën e politikave të vendeve në tri fusha kryesore: liritë ekonomike, sundimi i ligjit dhe investimi në njerëz, duke ofruar mundësinë për qasje në asistencën financiare të MCC-së. “Në vitin 2019

Kosova krahasohej me shtete me të ardhura të mesme të ulëta si Gana, Nepali dhe Hondurasi. Sot, në vitin 2025, krahasimi bëhet me një grup më të madh të shteteve, e që kanë të ardhura të mesme të larta, ashtu si Armenia dhe Gjeorgjia, duke reflektuar progresin tonë edhe në

krahasim me të kaluarën. Kosova ka bërë përparimin më të madh në rajon në politikat fiskale dhe luftën kundër korrupsionit, me avancim prej 75 %, krahasuar me Shqipërinë (56 %) dhe Maqedoninë e Veriut (53 %). Ky raport konfirmon përparimin e Kosovës drejt zhvillimit ekonomik dhe



qeverisjes së drejtë e demokratike”, ka bërë me dije Rizvanolli.

## Lansohet parakualifikimi për projektin e ruajtjes së energjisë përmes baterive

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 10 JANAR - Kryeministri Albin Kurti dhe ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, morën pjesë të premtën në ceremoninë e lansimit të Parakualifikimit për Projektin e Ruajtjes së Energjisë përmes Baterive të cilat do të vendosen në qytetet Ferizaj dhe Istog. Në fjalën e tij hyrëse, kryeministri Kurti ka thënë se me lansimin e parakualifikimit për ndërtimin e sistemeve të ruajtjes së energjisë me bateri që do të vendosen në Ferizaj dhe në Istog, shënojnë një tjetër ngjarje në kapitullin e investimeve dhe sigurisë energjetike të Kosovës. “125 MW të këtij sistemi do të operojnë nën Korporatën për

Ruajtjen e Energjisë dhe 45 MW të tjera nën KOSTT-in, të dyja këto ndërmarrje publike, të dyja në shërbim të vendit e të qytetarëve. Me ndërmarrjet tona publike, me aleatin tonë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, miq dhe partnerë, jetësojmë vizionin tonë për një sektor energjetik të qëndrueshëm dhe konkurrues”, ka thënë Kurti. Më tutje, veçoi rëndësinë e Instrumentit të Katalizatorit Amerikan për Zhvillim në kuadër të Programit Kompakt, i cili hap rrugën për financimin e projekteve që përqafojnë ekonominë e gjelbër dhe inovacionin. Programi Kompakt, i cili është financuar me 202 milionë dollarë nga Korporata e Sfidës së Mijëvjeçarit (MCC) dhe 34.7 milionë dollarë nga



Qeveria e Republikës së Kosovës, përfaqëson një investim të madh në pavarësinë tonë energjetike dhe qëndrueshmërinë afatgjatë. “Ky është një

moment i rëndësishëm për bizneset dhe sipërmarrësit tanë, një thirrje për të gjithë ata që duan të jenë pjesë e ndërtimit të një të ardhmeje të qëndrueshme dhe të

fuqishme për Kosovën”, tha kryeministri Kurti.

Ai shprehu edhe falënderimin për Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për mbështetjen dhe besimin e tyre në vizionin e qeverisë për një sektor energjetik të qëndrueshëm dhe konkurrues.

Ndërkaq ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, tha se “rruga jonë drejt tranzicionit energjetik të vendit është e qartë. Diversifikimi i burimeve të energjisë së pastër dhe rritja e kapaciteteve për ruajtje dhe furnizim të energjisë, së bashku me decentralizimin e rrjetit dhe kapaciteteve në menaxhimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë në rrjet, do të mundësohen përmes programit Kompakt dhe sistemit të Baterive”.

## Inflacioni në vitin 2024 ishte 1,6 për qind më i lartë se një vit më parë. Në çka pati rritje të çmimeve?



PRISHTINË, 10 JANAR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit për vitin 2024. ASK-ja njofton se indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit në vend në vitin 2024 ishte më i lartë në një mesatare prej 1,6 % krahasuar me vitin 2023. Agjencia njofton se ngritja e indeksit të çmimeve të konsumit është vërejtur te grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: biletat e fluturimeve 10,8 %, kaffja, çaji dhe kakao 8 %, pijet alkoolike 6,9 %, mallrat dhe shërbimet

për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake 6,5 %, shërbimet financiare 5,8 %, uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet 5,3 %, qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës 5,2 %, sheqeri, reçeli, mjalti, çokollata dhe ëmbëlsirat 5,1 %, pemët 4,8 %, gazetatat, librat dhe materialet për zyra 4,6 %, veshje 4 %, kujdesi personal 3,7 %, energjia elektrike 3,4 %, lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj 3,3 %, duhani 2,7 %, buka dhe drithërat 2,5 %, shërbimet hoteliere 2 % dhe mishi 1,9 % me një ndikim te

përbashkët prej 2-përqindësh në IHÇK.

Ndërsa rënie e indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit gjatë vitit 2024 është vërejtur te nëngrupeve e COICOP-it: karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal -4,4 % dhe blerja e automjeteve (-1,8 %) me një ndikim te përbashkët prej -0,4-përqindësh në IHÇK. Ndërkaq indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,1 % në muajin dhjetor 2024 krahasuar me muajin dhjetor 2023.

## Peci nënshkruan programin për pagesa direkte për vitin 2025

Prishtinë, 10 janar - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci ka njoftuar se ka nënshkruar Programin për

Pagesa Direkte 2025. “Mirëmëngjesi qytetarë të Republikës së Kosovës. Sapo nënshkrova

Programin për Pagesa Direkte 2025. Vazhdon përkrahja e fuqishme edhe këtë vit për fermerët në

katëgorinë e subvencioneve”, ka shkruar në “Facebook” ministri Peci.





# Los Angeles, agonja e qytetit të engjëjve



Los Angeles — Edhe zbritja në aeroportin LAX, në këto orë tragjike, është një bast. Kur avioni i parë që u nis në agim nga Nju Jorku afrohet, kapiteni informon pasagjerët si të ishte Indiana Jones: «Nëse kemi fat, ia dalim të mbërrijmë. Pista tani është e hapur, por gjithçka varet nga drejtimi i tymit».

Era është aq e rëndë, sa të mbush hundët sapo hapen dyert e avionit. Bertolt Brecht shkruante kështu: «Ferri duhet të jetë si Los Angeles». Ai i referohej kulturës së korruptuar, sipas tij, që shkatërronte qytetin e engjëjve. Por përballë shkatërrimit dhe vdekjes së shaktuar nga zjarret që po e përpijnë, revista The Hollywood Reporter vëren se tani vargjet e poezisë «Contemplating Hell» tingëllojnë profetike.

Sikur vetë zjarri të donte – nuk është një film apokaliptik, por të kujton shumë një të tillë – të pastronte një komunitet tashmë të humbur. Në kuptimin moral, për ata që ndodhen në kampin e luftës kulturore amerikane dhe janë të lumtur që Trump është kthyer në Shtëpinë e Bardhë,

por mbi të gjitha në kuptimin praktik, për shkak të thatësisë së shaktuar të paktën pjesërisht nga ndryshimet klimatike që presidenti i ri i mohon, erërave të Santa Ana që fryjnë me mbi 160 kilometra në orë, hidrantëve që kanë mbetur pa ujë nga pakujdesia dhe për shkak se nuk ka rënë shi për muaj të tërë, dhe bimësisë së përflakur që askush nuk është kujdesur me të vërtetë ta pastrojë. Të gjitha këto janë metafora të një vendi që është njëkohësisht i bekuar dhe i mallkuar nga fati.

Një vend që mes zjarreve, tërmeteve dhe kërcënimeve të tjera është gjithnjë e më i brishtë, duke i detyruar banorët të firmosin një pakt të përhershëm me djallin: të pranojnë rrezikun e përhershëm të largimit, të përgatiten për më të keqen, në këmbim të privilegjit të të jetuarit pranë Oqeanit Paqësor, me diellin gjithmonë të ndezur, siç këndonte filmi La La Land, në vendin ku lindin iluzionet e kinemasë, mes festave të mrekullueshme dhe mundësive sociale që pjesa tjetër e Amerikës mund vetëm t'i ëndërrojë.

## Shkatërrimi

Shkatërrimi është i dukshëm me sy të lirë. Tre zjarret kryesore në Palisades, Hollywood Hills dhe Eaton kanë djegur mbi 2,000 ndërtesa dhe 29,000 hektarë tokë, ekuivalente me 22,000 fusha futbollit, ose, siç do të thoshte popullsia tani dominuese latine. Të paktën dhjetë njerëz kanë humbur jetën, trupat e të cilëve u gjetën në tre ndërtesa në Altadena, por sherifi Robert Luna paralajmëron: «Është një vlerësim optimist, numri do të rritet».

Erërat janë ngadalësuar, por meteorologët parashikojnë kushte të favorshme për zjarrin të paktën deri nesër. Më shumë se 16 milionë njerëz në Kaliforninë e Jugut, nga vilat e aktorëve në Malibu deri te muri i ngritur nga Trump në kufi me Meksikën, janë brenda zonave me alarm të kuq.

Digjen ikonat e mitologjisë kinematografike, nga Sunset Boulevard te Mulholland Drive. Flakët po prekin studiot, Hollywood Walk of Fame, Chinese Theater dhe Dolby Theater, ku mbahen çmimet Oscar. Janë shkatërruar shtëpitë që i përkisnin Will Rogers, Billy Crystal dhe Paris

Hilton, si dhe Topanga Ranch Motel i ndërtuar nga William Hearst, i njohur ndryshe si «Citizen Kane» për shkak të Orson Welles.

Po digjet parku i Getty Museum. Hotelet e Disneyland janë mjaft larg flakëve dhe janë shndërruar nga parajsja për turistët në strehë për të evakuuarit. Dëmet vlerësohen në 50 miliardë dollarë. Është shtyrë ndeshja e basketbollit e Lakers, ndërsa UCLA i ka transferuar mësimet online. Patrice Winter, pronarja e pasticerisë Canyon Bakery, ankohet për Los Angeles Times: «Është si Armagedoni». Shana Soboroff rrëfen frikën e familjes së saj: «Nuk kishte alarme, por erërat u bënë shumë të forta. Po godisnin shtëpinë dhe ne ikëm». Në ndërtesat e braktisura, njëzet persona janë arrestuar për grabitje.

## Dimensioni social dhe politik

Jack Kerouac vërente se edhe në Nju Jork ekzistonte një farë kameraderie, kur kalimtarët e shpejtë takohen dimrit në rrugët e ngrira, por në Los Angeles jo: asnjë mëshirë,

asnjë ndjenjë humaniteti. Ndoshta e ekzagjeronte, por duke parë si politika shfrytëzon tragjedinë, mund të dyshosh se kishte të drejtë. Kryetarja e bashkisë, Karen Bass, e zgjedhur për të pastruar qytetin dhe për të trajtuar krizën e të pastrehëve përgjatë Skid Row, u kap në befasi nga kriza.

Mund të imagjinoni reagimin e atyre që urojnë kolapsin e qytetit të engjëjve, edhe pa tërmetin e madh të shumëpritur, i quajtur «Big One». Presidenti Biden ndodhej rastësisht këtu, për të shpallur dy rezerva natyrore dhe për të pritur lindjen e një nipi. U largua për të marrë pjesë në varrimin e Carter, duke anuluar udhëtimin në Romë që ishte i papërbullueshëm për imazhin publik. Menjëherë e shfrytëzoi Trump, i cili çdo natë ëndërron rënien e Kalifornisë liberale, për të fajësuar guvernatorin Newsom («Newscum») për ferrin që po ndodh.

Ndoshta sepse frikësohet se në 2028 do të kandidojë kundër tij, me më shumë shpresë sesa Kamala për ta ndaluar ëndrrën e Trump për një mandat të tretë, ose për të ndaluar zv. Presidentin Vance. Ndërkohë, Los Angeles po digjet. / bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON Inverit  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



# Përballen kampioni dhe nënkampioni

**MITROVICË, 10 JANAR** - ProCredit Superliga vazhdon me super ndeshje në fundjavë, ku zhvillohet xhiroja e 16. Sfida kryesore do të zhvillohet ndërmjet Trepçës dhe Golden Eagle Yllit, apo kampionit dhe nënkampionit. Mitrovicasit janë liderë me 11 fitore e katër humbje, ndërsa therandasit ndodhen në vendin e gjashtë me shtatë fitore e tetë humbje. Takimi është shumë i rëndësishëm, andaj të dyja skuadrat hyjnë vetëm për fitore. Të dielën do të përballen skuadrat prishtinase, Sigal Prishtina-Bora, në një sfidë emocionuese. Në stinorin vjeshtor të dyja skuadrat kishin nga një fitore ndaj njëra-tjetrës, andaj pritet një ndeshje shumë interesante në kryeqytet. Sigal Prishtina ka shtatë e tetë humbje, ndërsa Bora pesë fitore e dhjetë humbje. Takim interesant pritet edhe në Prizren, ku përballen dy skuadrat në



formë, Bashkimi dhe Vëllaznimi. Prizrenasit ndodhen në vendin e dytë me dhjetë fitore e pesë humbje, ndërsa kuqezinjtë tetë fitore e shtatë humbje, ku kanë katër fitore radhazi. Ndeshja e fundit e

kësaj xhiroje është ndërmjet Pejës dhe Proton Cable Prizrenit, ku fitorja është e vlefshme për të dyja skuadrat. Verdhezinjtë kanë tetë e shtatë humbje, ndërsa prizrenasit katër fitore e 11 humbje.

## PROCREDIT SUPERLIGA-JAVA 16

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Trepça - Golden Eagle Ylli

**Të dielën takohen:**  
17:00 Sigal Prishtina - Bora  
17:00 Bashkimi - Vëllaznimi  
19:00 Peja - Proton Cable Prizreni

## SHKURT

### Marijan Coric rikthehet te Llapit

Portieri i njohur Marijan Coric është rikthyer në skuadrën e Llapit. Klubi llapjan beson se me rikthimin e shtatëllartit porta do të jetë e sigurt në rrugëtimin drejt plasmanit që e dërgon në garat evropiane. "Drejtuesit e klubit dhe portieri shtatëllartë kanë arritur akordin për kontratë 1.5-vjeçare. 'Mario' rikthehet sërish në Podujevë për t'i ndihmuar skuadrës drejt arritjes së objektivave. Ai ka mbyllur kontratën me ekipin kroat NK Istra 1961 për t'u bashkuar me Llapin, që para dy sezonesh e ndihmoi në fitimin e Kupës së Kosovës dy herë radhazi dhe një herë Superkupën. Pas Kupës së dytë të fituar, Coric u largua kampion dhe la vend për rikthimin e tij, duke qenë një nga futbollistët më të dashur të publikut llapjan. Tashmë ai kthehet sërish me të njëjtin mision për ta çuar ekipin drejt suksesit, plasmanit në Evropë", thuhet në njoftimin e Llapit.

### Suhareka sot zhvillon ndeshje miqësore me Lirinë

FC Suhareka ka vazhduar stërvitjet e rregullta në vitin e ri kalendarik 2025 për fazën e parë përgatitore ku po mbizotëron një atmosferë ekipore me shumë motivim. Kjo skuadër të shtunën ka aranzhuar miqësoren e parë ndaj KF Liria në stadiumin "Përparim Thaqi" në Prizren me fillim nga ora 13:00. Ndërsa fazën e dytë përgatitore do ta zhvillojë në Turqi. "Faza e dytë e përgatitjeve do të zhvendoset në Antalya të Turqisë nga data 15/01 ku do t'i zhvillojmë edhe ndeshjet kontrolluese ndaj disa skuadrave. Për të gjitha të rejat e klubit ndryshimet e lojtarëve dhe gjithçka tjetër do të njoftoheni me kohë në rrjetet tona sociale", thuhet në njoftimin e Suharekës.

### FShF-ja rinovon kontratën e trajnerit Alban Bushi

Federata e Futbollit e Shqipërisë (FShF) ka njoftuar zyrtarisht rinovimin e kontratës me trajnerin e ekipit U-21, Alban Bushi. Bushi do të jetë edhe më tutje trajner i ekipit kombëtar U-21 të Shqipërisë pavarësisht prej mungesës së sukseseve. Është vetë faqja zyrtare e FShF-së e cila ka njoftuar rinovimin e kontratës me Bushin edhe për një vit e gjysmë, duke tentuar ta plotësojnë një 10-vjeçar së bashku. "Federata e Futbollit ka rinovuar kontratën me trajnerin e Kombëtares U-21, Alban Bushi. Marrëveshja e re do të jetë e vlefshme deri në fund të vitit 2026", thuhet në njoftim. Më tutje, FShF-ja ka thënë se Bushi dhe stafi i tij do t'i vijojnë përgatitjet për ndeshjet e ardhshme kualifikuese, me qëllim arritjen e rezultateve sa më pozitive. Sipas FShF-së, rinovimi i kontratës me trajnerin Alban Bushi synon ta sigurojë vazhdimësinë e këtij procesi.

# Fressange dhe Isufi largohen nga Drita

**GJILAN, 10 JANAR (ER)** - Skuadra e Dritës nga Gjilani ka njoftuar të premtën se futbollisti nga Franca, Alexandre Fressange, nuk do të jetë më pjesë e klubit. Deri te kjo ndarje ka ardhur për faktin se Fressange nuk arriti të përshtatet me klubin. "Kemi mbyllur bashkëpunimin edhe me francezin Alexandre Fressange. Alexi u bashkua me ekipin në verë të këtij viti, por nuk arriti asesi të përshtatet me ekipin. Zgjidhja më e mirë për të dyja palët ishte ndërprerja e bashkëpunimit për t'i hapur rrugë lojtarit për sfida të reja. Klubi i uron suksese Alexit në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e Dritës.

Klubi gjilanas, po ashtu, bëri me dije se e ka mbyllur bashkëpunimin me marrëveshje të dyanshme me futbollistin Dienit Isufi. Në sezonin 2021/22, Dieniti arriti të nënshkruante kontratë profesionale me klubin dhe ishte pjesë e rregullt e ekipit të parë. Gjatë kësaj periudhe Isufi ishte i huazuar dy herë te KF Kika (gjashtë muaj) dhe KF Ramiz Sadiku (gjashtë muaj). "Klubi ynë ka mirëkuptuar Dienitin për ta liruar nga kontrata pasi i njëjti ka shprehur dëshirën për të provuar një sfidë të re ku mund të ketë më shumë hapësirë për të luajtur", thuhet në njoftimin e klubit gjilanas.





## Verstappen: Titulli për konstruktorë ishte një dështim për Red Bullin, por jo për faj të Perezit

**MILTON KEYNES, 10 JANAR** - Edhe pse piloti holandez Max Verstappen fitoi titullin kampion bote për pilotë vitin e kaluar, për makinën Red Bull botërori 2024 ishte një dështim. Makina austriake lëshoi fronin si "e pakapshme" në vitin 2023, duke u kthyer në forcën e tretë, pas McLarenit dhe Ferrarit. Madje në disa

gara të gjysmës së dytë të sezonit Red Bulli ishte forca e katërt edhe pas Mercedesit, sinjal ky që gjërat mund të jenë problematike vitin tjetër. Ai që pagoi shtrenjtë këtë rezultat ishte piloti meksikan Sergio Perez, apatik në gjysmën e dytë të sezonit dhe u largua nga skuadra (u zëvendësua nga Liam Lawson). Gjithsesi,

Verstappen e mbron ish-shokun e skuadrës: "Padyshim që ishte një dështim i mjerueshëm. Ishte një vit i vështirë për Checo dhe mendoj se nuk ishte gjithmonë faji i tij. Kishim edhe një makinë shumë të vështirë në atë kohë. Nuk ishte tërësisht faji i tij që gjërat shkuan kaq keq". "Problemi më i madh që

kishim vjet ishte se makina nuk po funksiononte, ishte shumë e vështirë për t'u drejtuar. Ishte e njëjta gjë edhe për mua. Duhej të kishim filluar të punonim më herët, sepse kjo do ta kishte ndihmuar shumë edhe atë. Në një çast të caktuar të vitit gjërat u bënë shumë të vështira. Kjo nuk është e mirë për besimin dhe



disa pilotë janë më të ndjeshëm se të tjerët", ka shtuar Verstappen.

## Broja pëson lëndimin e shtatë në karrierë

**LIVERPOOL, 10 JANAR** - Armando Broja u dëmtua sërish mbrëmë, në ndeshjen e Evertonit kundër Peterboroughit. Fotot e këtij momenti dhembin vërtet shumë. Kujtojmë se Broja, pas lëndimit në verë, nuk u rikthye deri më 29 nëntor tek Evertoni (ku është huazuar këtë sezon nga Chelsea), ndërsa u zëvendësua ndaj Bournemouthit pas lëndimit joserioz. Mbrëmë u lëndua përsëri ndaj Peterboroughit. Lëndimi i tij në verë solli bllokimin e transferimit të përhershëm tek Ipswich Towni. Ky ishte lëndimi i shtatë në karrierë, ose ndryshe 418 ditë jashtë fushave të blerta, në moshën 23-vjeçare. Sulmuesi 23-vjeçar duket se përplasi këmbën në një mënyrë të pazakontë, pasi u pengua nga mbrojtësi i Peterboroughit, Emmanuel Fernandez. Broja kishte zëvendësuar shënuesin e golit, Beto, në minutën e 65-të të ndeshjes, me Evertonin që



transferimit të tij në formë huazimi nga Chelsea këtë verë. Broja kishte qenë jashtë fushave deri në dhjetor për shkak të një dëmtimi në tendinën e Akilit, të pësuar gjatë parasezonit, gjë që kishte ndërprerë transferimin e tij të mundshëm tek Ipswich. Më parë ai ishte larguar nga fushat midis dhjetorit 2022 dhe shtatorit 2023 për shkak të një dëmtimi të rëndë në ligamentin e kryqëzuar të përparmë të gjurit, për të cilin kreu operacion. Në janar 2024 Broja u transferua në formë huazimi te Fulhami, në përpjekje për më shumë minuta lojë. Atje u kufizua në vetëm 8 paraqitje si zëvendësues, pa filluar asnjë ndeshje si titullar gjatë asaj periudhe huazimi. Broja ka luajtur 38 herë për klubin e tij të origjinës, Chelsea, duke shënuar 3 gola. Ai ende nuk e ka gjetur rrugën e rrjetës për Evertonin.

kryesonte 1-0. Në minutën e 86 ai kaloi portierin e Peterboroughit, Nicholas Bilokapic, por ndërhyrja e mbrojtësit Fernandez e ndali atë. Sulmuesi fatkeq shqiptar u duk se ra keq dhe menjëherë tregoi shenja shqetësimi të madh. Ai mori trajtim të gjatë mjekësor në fushë, teksa u pa duke goditur tokën me duar nga zhgënjimi. Broja, të cilit iu dha oksigjen gjatë trajtimit, përfundimisht u largua nga fusha e stadiumit "Goodison Park" me barelë. Sulmuesi i kombëtares së Shqipërisë po bënte vetëm paraqitjen e tij të gjashtë për Evertonin, pas

## Clevelandi nuk njeh rivalë në NBA

**CLEVELAND, 10 JANAR** - Kryesuesit e Clevelandit nuk ndalin marshimin e tyre këtë sezon në NBA, duke fituar me rezultat 132-126 ndaj Torontos, duke prekur kuotën e 33 fitoreve. Darius Garland me 40 pikë ishte lojtari më i mirë në fushë për Cavaliersin. Rikthehet te fitorja e ekipi i Golden States, që falë një



loje të mirë kolektive, mundi me rezultat 107-104 Detroitin. Ndërkohë, zjarret që kanë pushtuar Los Anxhelosin, tashmë në gjendje të jashtëzakonshme, kanë sjellë anulimin e ndeshjes mes Lakersave dhe Charlottes. Në

takimet e tjera Miami fitoi me rezultat 97-92 në fushën e Utah Jazzit, sfidë ku protagonist ishte Tyler Herro me 23 pikë. Fitoi edhe ekipi i Dallasit, 117-111 ndaj Portlandit, sfidë ku Jaden Hardy realizoi 25 pikë për teksanët.

### REZULTATET

Cleveland - Toronto	132-126
Detroit - Golden State	104-107
Orlando - Minnesota	89-104
Memphis - Houston	115-119
Dallas - Portland	117-111
Phoenix - Atlanta	123-115
Utah Jazz - Miami	92-97
Lakers - Charlotte	(e shtyrë)

## Juventuesi, afër marrëveshjes me Araujon dhe Muanin

Juventusi duket se ka arritur të realizojë dy goditje në ardhje në merkaton e janarit. I pari është mbrojtësi Ronald Araujo nga skuadra e Barcelonës, i cili do të vijë në

formë huazimi, teksa klubi torinez do ta paguajë vetëm pagën e tij. Mbrojtësi është shumë i pakënaqur me faktin se është zgjedhur e tretë në ekipin e Flickut, ndaj dhe

kërkon më shumë hapësira. Juventusi me dëmtimin e rëndë të Bremerit dhe Cabalit që kanë mbyllur sezonin, do të tentojë afrimin e një tjetër mbrojtësi

ku Antonio Silva nga Benfica është një objektivi konkret. Sa iu përket afrimeve është arritur akordi edhe me Kolo Muanin, sulmuesi i PSG-së, që ka vendosur të kalojë në

Torino. Edhe ai pritet të vijë në formë huazimi, ndërkohë që kujtojmë se PSG-ja pagoi 100 milionë euro një vit më parë për ta marrë nga Eintracht Frankfurti.

### SHKURT

#### Marku arrestohet edhe në Angli

Nga një burg në tjetrin. Vetëm pak ditë pasi u lirua në Gjermani, boksieri Florian Marku është arrestuar sërish, por këtë herë në Angli. Ai është vënë në pranga për të njëjtën çështje që u ndalua në Gjermani, për një urdhër arrest ndërkombëtar të lëshuar nga Greqia. Marku ndodhet në qelitë e Anglisë, në pritje të ekstradimit në Greqi, për ta kryer dënimin e një ngjarje të vitit 2010, ku pati një sherr me disa rusë në një klub nate. Florian Marku ka kryer 1,5 vjet burg, ndërsa është dënuar me 7 vjet burg. Për shkak të rihapjes së çështjes duhet të kryejë dhe një pjesë të dënimit.

#### Partizani paraqet Besar Guxhufin

Jo vetëm merkato në dalje, Partizani lëviz edhe në hyrje duke paraqitur blerjen e tyre të radhës, Besar Guxhufin. Sulmuesi 20-vjeçar është përforcimi i radhës i të kuqve për gjatë merkatos së janarit. Guxhufi, një prej talentëve të ekipit tonë përfaqësues U-21, ka firmosur një kontratë të vlefshme deri në vitin 2029. Sulmuesi mbërrin te Partizani pas përvojave pozitive te skuadra e 19-vjeçarëve të Beshiktashit dhe Shkupit. Kjo është dhurata e radhës për trajnerin Veselinović përpara sfidës së parë për këtë vit, ndeshjes kundër Skënderbeut.

#### Anelotti: Finalja do të jetë argëtuese

Trajneri i Real Madridit, Carlo Anelotti, ka folur pas fitores ndaj Mallorcas në gjysmëfinalen e Superkupës së Spanjës, e cila ia siguroi një vend në finalen e madhe. Reali do të përballlet me Barcelonën në finalen e Superkupës së Spanjës dhe trajneri i "Los Blancos" nuk duket i sigurt për "El Clasico"-n. "Në kohët e fundit, 'El Clasico' ka qenë gjithmonë e paparashikueshme. Ka pasur ndeshje që ne i kemi fituar lehtësisht dhe të tjera ku na kanë mundur 0-4", ka thënë fillimisht Anelotti. "Është e vështirë të mendosh se si do të jetë finalja, por do të jetë argëtuese sepse do të ketë shumë talentë në fushë. Unë nuk e di se si do të shkojë. Ne do të përpiqemi të bëjmë më mirë se Barcelona", ka përfunduar trajneri italian. Ndryshe, ndeshja "El Clasico" e finales së Superkupës së Spanjës është paraparë të zhvillohet këtë të diel, më 12 janar, nga ora 20:00.

#### Arsenali interesohet për transferimin e Rashfordit

Arsenali thuhet se ka filluar kontaktet me rivalët e Manchester Unitedit për transferimin e sulmuesit Marcus Rashford. Sipas mediumit "Sky Italia", Arsenali ka kontaktuar Unitedin në lidhje me një lëvizje të mundshme prej 21 milionë funtesh apo rreth 25 milionë euro për Rashfordin. Pavarësisht se ka një kontratë në "Old Trafford" deri në vitin 2028, sulmuesi anglez ka qëndruar në stol për të gjithë muajin dhjetor nën drejtimin e trajnerit Ruben Amorim. Burimet sugjerojnë se Rashfordi është i hapur për një lëvizje në janar, me lojtarin që është në bisedime edhe me klubet e Serisë A. Interesi i Arsenalit vjen teksa ata kërkojnë ta forcojnë skuadrën e tyre, me situatën e Rashfordit që potencialisht ofron një shans për një transferim.





Prishtinë 10000 Kosovë. Rruga "TIRANA" nr. 125 Tel. +383 (0) 38 613 026

Nr. i protokolit: 274

Data: 10.01.2025

Bazuar në nenin 28, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/1 – 138, i datës 28.02.2013 për arsimin dhe aftësimin profesional dhe në bazë të nenit 12, paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L – 143, i datës 13.12.2012, për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe në bazë të rregullores (MASHT) nr. 01/2017, të datës 02.02.2017, për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave nga aftësimi profesional dhe arsimit për të rritur, rregulloren për planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimi profesional dhe arsimit për të rritur, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr) shpallë :

## KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë (10) për vijimin e mësimi për të rritur në Qendrën e Kompetencës "SHTJEFËN GJEÇOVI" në Prishtinë, për vitin shkollor 2024/2025, afati i Qershorit,

### në këto profile:

- Dirigjimi kompjuterik i makinave
- Metalpunues
- Automekanik
- Mekatronikë
- Instaluesi i ujësjellësit dhe kanalizimit dhe ngrohjes dhe klimatizimit
- Floktari
- Konfeksioner
- Rrobaqepës
- Transport rrugor
- Trafik rrugor
- Transport hekurudhor (Drejtues i trenave, Lëvizje e trenave, Tërheqje e trenave).

### KUSHTET:

Regjistrimi i vijuesve në programin arsimi për të rritur bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt siç është paraparë në Ligjin nr.04/L – 143 për arsimin dhe aftësimin për të rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve të MASHT-it, UA 11/2011, UA 16/2011 i datës 30.12.2011 ; UA 12/2014, i datës 05.05.2014, dhe UA 13/2014, i datës 05.05.2014.

Të drejtë regjistrimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët kanë moshën për të qenë nxënës në arsimin për të rritur.

### Dokumentet e nevojshme për regjistrim:

- Dëftesa e klasëve të kryera paraprake
- Certifikata e lindjes
- Pagesa

Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë është me pagesë. Partecipimi bëhet në bazë të UA 11/2011, i datës 30.12.2011.

### Pagesa e regjistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur:

- a) Për regjistrim të vitit për një klasë .....100,00 €
- b) Për praktikë profesionale .....50,00 €
- c) Për provim diferencial ..... 10,00 €
- d) Provimi përfundimtar /certifikata – diploma .....50,00 €

Pagesat bëhen në institucionet financiare sipas kodit të shkollës.

Dëftesat dhe diplomat që merren në programin "Arsimi dhe aftësimi për të rritur" janë të barasvlershme me diplomat e arsimit formal.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Françeskina Zef Pjetri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e katër viteve të sh.m.m. "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Fitim Mehmet Zeneli shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës, me nr. 38/3.

- Armend Durmishaj shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme sh.m.l.p. "7 Shtatori" Prishtinë.

- Armend Durmishaj shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Anton Çeta" Skenderaj.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales







**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

